

Raporti vjetor 2015

Raporti vjetor i Institutit të Statistikave

INSTAT - Instituti i Statistikave

Tel+(355) 4 2222411 / +(355) 4
2233356
Fax+(355) 4 2228300

Bul."Zhan D'Ark", Nr .3 Tiranë,
Shqipëri

info@instat.gov.al

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Lista e shkurtimeve	3
HYRJE	4
Funksionimi i INSTAT	5
Objektivat strategjike të PSZ 2012-2016	8
Aktivitetet kryesore për vitin 2015	9
Përmbushja e detyrimeve të PSZ 2012-2016	12
Cilësia e të dhënave	13
Ngarkesa e të Intervistuarve	16
Analiza SWOT	21
Aksione të reja statistikore gjatë vitit 2016	23
Burimet njerëzore dhe financiare	26
Integrimi Evropian dhe Koordinimi i Projekteve	34
Atlasi Statistikor WEBGIS	42
Publikimet - Databaza e kërkesave të përdoruesve	44
Publikimet - Të dhënat e faqes www.instat.gov.al	56
Kontaktet e institucionit	60

Lista e shkurtimeve

AFP	Anketa e forcave të punës
AKP	Anketa e kostos së punës
ANR	Anketa e ndërmarrjeve të reja
ANJL	Anketa e njësive lokale
APC	Anketa post-census
ASN	Anketa strukturore e ndërmarrjeve
ATN	Anketa tremujore e ndërmarrjeve
BE	Bashkimi Evropian
CAPI	Intervista me kompjuter
CATI	Intervista me telefon
CFCU	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve
DAP	Departamenti i Administratës Publike
EDP	Procedura e Deficit të Tejkualuar
ESA	Sistemi Evropian i Llogarive
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GIS	Informacioni Gjeo-hapsinor
IÇK	Indeksi i çmimeve të konsumit
IÇP	Indeksi i çmimeve të prodhimit
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumenti Mbështetës para Pranimit në BE
ISCO	Klasifikimi i Profesioneve
NVE	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike
NJEF	Njësi ekonomike familjare
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare
SCB	Zyra e statistikave të Suedisë
SIDA	Agjencia Suedeve për Zhvillim

HYRJE

Të dashur lexues,

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) është institucioni që disponon burimin më të madh të informacionit statistikor zyrtar në Shqipëri. Funkzioni kryesor i tij është të japë informacion mbi situatën ekonomike, demografike, sociale dhe mjedisore përdoruesve kryesor të cilët përfshijnë: institucionet publike, rrethet e kërkuesve dhe akademikëve, organizatat ndërkombëtare dhe lokale si dhe individë të interesuar për qëllimet e tyre. Një angazhim maksimal i institucionit ka qenë në drejtim të harmonizimit të statistikave me klasifikimet dhe metodologjinë ndërkombëtare në përputhje me parimet e paanshmërisë, besueshmërisë, përkatësisë, përfitueshmërisë, konfidencialitetit si dhe transparencës së statistikave. Në prodhimin e statistikave INSTAT udhëhiqet nga Programi Statistikor Zyrtar (PSZ). Ky dokument është dokumenti bazë në të cilën përcaktohen dhe parashikon statistikatat e nevojshme që duhet të prodhojë i gjithë sistemi statistikor për monitorimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë.

Një vlerë të shtuar të punës së tij, INSTAT konsideron bashkëpunimin ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit si një mjet mjaft i rëndësishëm për garantimin e mirëfunksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe arritjen e objektivave të parashikuara në Programin e Statistikave Zyrtare.

Ky raport është një raport gjithëpërfshirës dhe i integruar i cili përfshin të gjithë aktivitetet kryesore të INSTAT gjatë vitit të kaluar. Qëllimi i tij është t'u japë palëve të interesurara një pamje të të gjithë aktiviteteve statistikore dhe performancës së institucionit.

Funksionimi i INSTAT

Misioni i INSTAT

Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika asnjëanëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit.

Vizioni i INSTAT

Si institucioni që disponon burimin më të madh të informacionit statistikor në Shqipëri, INSTAT përpiqet t'u përgjigjet kërkesave gjithnjë e në rritje të përdoruesve për vendimmarrje, kërkime dhe arsimim në Shqipëri. Gjithashtu, INSTAT ndihmon komunitetin e interesuar ndërkombëtar nëpërmjet sigurimit të informacionit statistikor relativ, të sigurt dhe të krahasueshëm.

Me dëshirën për të mësuar dhe me forca të shumta për të identifikuar nevojat e klientëve, INSTAT ngre një rrjet sistematik për marketingun dhe shpërndarjen e informacionit statistikor, duke përdorur struktura të një rrjeti modern dhe teknologji të informacionit.

Legjislacioni

Veprimtaria e INSTAT regullohet me Ligjin Nr.9180, datë 5.2.2004 "PËR STATISTIKAT ZYRTARE", ndryshuar me: Ligjin nr. 21/2012 "Për një ndryshim në Ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikat zyrtare"; dhe me Ligjin nr. 7/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikat zyrtare", i ndryshuar"

Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare

Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare (PSZ) është dokumenti bazë që parashikon prodhimin nga

Sistemi Kombëtar Statistikor të të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar garancinë e

zbatimit të parimeve statistikore të parashikuara në ligj si dhe në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice)¹.

Parimet e statistikave zyrtare

Për të siguruar besueshmërinë e publikut në statistikat zyrtare, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore duhet të udhëhiqen nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane.

Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane përcakton standarde për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane. Ai është ndërtuar mbi një përkufizim të përbashkët të Sistemit të Statistikave Evropiane (SSE) të cilësisë në statistika dhe synon të gjitha fushat e rëndësishme të mjedisit institucional, proceset e prodhimit të statistikave deri në publikimin e statistikave zyrtare evropiane.

Organizimi dhe zbatimi i programit statistikor kombëtar udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- a) "paanshmëria", që nënkupton mënyrën objektive dhe të pavarur të prodhimit të statistikave, të lira nga çdo presion politik ose i grupeve të tjera të interesuara, veçanërisht lidhur me përzgjedhjen e teknikave, përkufizimeve dhe metodologjisë më të mirë të përshtatshme për të arritur objektivat e vendosur. Ajo nënkupton disponueshmërinë e statistikave me një vonesë sa më të vogël për të gjithë përdoruesit;
- b) "besueshmëria", që është karakteristikë e statistikave për të reflektuar sa më të besueshëm që të jetë e mundur realitetin, të cilin ato janë parashikuar të përfaqësojnë. Ajo nënkupton përdorimin e kriterëve shkencorë për zgjedhjen e burimeve, metodave dhe procedurave;
- c) "pavarësia profesionale", që personelit të INSTAT-it ose të agjencive statistikore, gjatë zbatimit të programit, nuk i lejohet të kërkojë ose të marrë udhëzime nga Qeveria, autoritetet e tjera shtetërore, partitë politike ose çfarëdo lloj grupi tjetër i interesuar, veçanërisht në përzgjedhjen e burimeve të të dhënave, metodave dhe procedurave statistikore, në përmbajtjen, formën dhe kohën e shpërndarjes, si dhe në zbatimin e konfidencialitetit statistikor;

¹ <http://ec.europa.eu/eurostat/web/quality/european-statistics-code-of-practice>

Objektivat strategjike të PSZ 2012-2016

INSTAT mbështetur në objektivat e PSZ 2012-2016, gjatë vitit 2015 ka punuar për të realizuar:

1. Prodhimin e statistikave sa më cilësore, të kuptueshme dhe të besueshme për përdoruesit, duke e shoqëruar çdo statistikë me prodhimin e treguesve të cilësisë dhe hartimin e raportit të cilësisë. Ndërtimi i metadatave për çdo aktivitet statistikor në formë standarde dhe publikimi i tyre në faqen e web të INSTAT.
2. Ofrimin tek përdoruesit të treguesve të rinj dhe produkteve të reja statistikore, përmirësimi i treguesve ekzistues dhe respektimi i afateve kohore, do të jenë disa prej orientimeve kryesore për vitin në vazhdim.
3. Përmirësimin e teknikave të grumbullimit të informacionit statistikor duke përdorur metoda moderne si CAPI apo CATI të cilat shkurtojnë kohën e kapjes dhe përpunimit të të dhënave, si dhe do të përmirësojnë afatet e publikimit të tyre.
4. Respektimin e afateve të përcaktuara në kalendarin e botimeve të publikuar në faqen e INSTAT: www.instat.gov.al.

Aktivitete kryesore për vitin 2015

Gjatë vitit 2015 INSTAT është angazhuar për të realizuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Porgramit Kombëtar Statistikor 2012-2016. Ndër aktivitetet kryesore të tij kanë qenë:

Produktet mujore :

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (Dhjetor 2014 – Nëntor 2015)
2. Tregtia e Jashtme (Dhjetor 2014 – Nëntor 2015)

Produktet tremujore:

1. Buletini Statistikor
2. Tregtia me Pakicë
3. Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
4. Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (Për Banesa)
5. Statistikat Afatshkurtra
6. Anketa tremujore e forcave të punës
7. Vlera e Shtuar Bruto

Produkte gjashtëmujore:

- 1- Bilanci i Energjisë Elektrike Gjashtëmujori I - 2015

Produkte Vjetore të INSTAT:

1. Bilanci i Energjisë Elektrike 2014
2. Femra dhe Meshkuj 2015
3. Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve 2015
4. Tregu i Punës 2014
4. Popullsia e Shqipërisë 1 Janar 2015
6. Prodhimi i Brendshëm Bruto, Paraprak 2014
7. Regjistri i Ndërmarrjeve 2014

8. Prodhimi i Brendshëm Bruto Rajonal 2013
9. Shqipëria në Shifra 2014
10. Ecuria e Tregtisë së Jashtme 2014
12. Vjetari Statistikor 2010-2014
13. Tregtia e Jashtme e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve, 2011- 2014
14. Anketa e Kostove të Punës 2013
15. Vjetari Statistikor Rajonal, 2015

Konferenca të ndryshme ku janë prezantuar publikime të veçanta si:

1. “Prezantimi i rezultateve të Tabelave të Burim – Përdorimeve”, 06 Shkurt 2015
2. “Prezantimi i gjetjeve të Anketës të Kostos të Punës dhe Tregut të Punës 2014”, në Panairin e Punës, 01 Maj 2015
3. "Census 2011: Profili i Personave me Aftësi të Kufizuara dhe i Popullsisë Rome dhe Egjiptiane", 13 Maj 2015
4. “Publikimi "Femra dhe Meshkuj në Shqipëri, 2015", 20 Maj 2015
5. "Konferenca mbi Statistikat Rajonale dhe Buxhetin e Familjes 2014" 17 Shtator 2015
6. “Të rinjtë në Shqipëri: Sfidat në kohët që ndryshojnë”, 25 Nëntor 2015
7. Mplakja e Popullsisë: Situata e të moshuarve në Shqipëri, 25 Nëntor 2015

Aktivitete

1. "INSTAT kontribuon në politikat statistikore ndërkombëtare përmes anëtarësisë në Bordin e PARIS21", 28 Prill 2015
2. Binjakëzimi i INSTAT me Zyrën Qendrore të Statistikave të Irlandës, (CSO)"
3. Dita Botërore e Statistikave", 20 Tetor 2015
4. Përgatitja e aplikacionit për Emrat, bazuar në rezultatet e Censurit
5. Drejtoria e Statistikave Ekonomike ju nënshtrua procesit të vlerësimit të statistikave ekonomike mbi nivelin e përputhshmërisë së statistikave të prodhuara sipas parimeve të Kodit të Praktikave Evropiane, në kuadrin e projektit të ndërmarrë nga

Eurostat mbi “Vlerësimi i sistemeve statistikore dhe fushave statistikore të zgjedhura në vendet në zhvillim”.

6. U llogarit për herë të parë për nevoja të brendshme Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit.
7. U krye aktiviteti statistikor ad-hoc: “Mbikëqyrja dhe zgjerimi i tregut për fondin e pensioneve profesionale private” pranë ndërmarrjeve me pronësi private, në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe Bankën Botërore.
8. U krye në terren për herë të parë anketa mbi Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit pranë ndërmarrjeve si vërtetim më vete. Dizajni i pyetësorit, përzgjedhja e kampionit dhe përpunimi i të dhënave u mbështetën në Standartet Europiane për implementimin e këtij aktiviteti statistikor. Për grumbullimin e të dhënave u përdor për herë të parë teknika CAPI (me tablet).
9. U paraqitën për herë të parë të dhënat e PBB-së për vitet 2008-2014 sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2.
10. Është publikuar për herë të parë komponentet e taksave dhe subvencioneve mbi produktet duke kaluar nga Vlera e shtuar Bruto në PBB tremujor. Gjithashtu u publikuan për herë të parë komponentët kryesor të PBB me metodën e shpenzimeve
11. Hartimi dhe raportimi i të dhënave të EDP për Shqipërinë. Një grup pune ndër-institucional është formuar me përfaqësues nga INSTAT, Ministria e financave, Banka e Shqipërisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Kujdesit dhe Sigurimeve Shëndetësore, me qëllim shkëmbimin e të dhënave dhe ndarjen e dijeve të nevojshme në këtë fushë. Për të hartuar tabelat e EDP është i rëndësishëm përpilimi i sekuencës së plotë të llogarive të sektorit dhe nënsektorëve të qeverisë. Treguesit e të dhënave të EDP për vitet 2011-2014 u dërguan në Eurostat në muajt Prill dhe Tetor 2015 sipas programit të transmetimit të kërkuar nga EUROSTAT.

Përmbushja e detyrimeve të PSZ 2012-2016

INSTAT ka bërë përpjekje që të kryejë të gjitha detyrimet e tij që rrjedhin nga PSZ aktuale 2012-2016. Nga **120 aktivitete statistikore** të parashikuara në PSZ për vitin 2015 janë realizuar plotësisht 119 aktivitete.

Tabela 1 Lista e aktiviteteve të parealizuara apo jo të përputhura plotësisht me standartet e Eurostatit, për vitin 2015

Nr	Aktivitete	Kodi i Modullit	Situata
1	Shkaqet e vdekjeve sipas skedës për vdekjet mbi dhe nën një vjeç	1.05.01	Pa realizuar
2	Lista e produkteve (Lista e produkteve të Komunitetit PRODCOM)	3.01.03	Disponohet në nivelin 6 shifror dhe jo 8 shifror sipas kërkesave të Eurostatit
3	Vrojtimi vjetor në Bujqësi	4.01	Treguesit janë përlogaritur bazuar në të dhënat administrative

Shkaqet e mosrealizimit

Shkaqet në mosrealizimin e aktiviteteve janë të lidhura edhe me institucione të tjera apo në situatën konkrete të mosplotësimit të kushteve, në nivel vendi.

1. Me gjithë përpjekjet e INSTAT për të realizuar aktivitetin mbi “shkaqet e vdekjeve”, deri tani ka qenë i pamundur sigurimi i informacionit të plotë mbi këto shkaqe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
2. Përsa i përket “Listës PRODCOM”, Shqipëria akoma nuk i plotëson tërësisht kriteret e hartimit të kësaj liste deri në 8 shifrore konform standarteve evropiane. Kjo liste disponohet në nivel 6 shifror.
3. Mungesa e regjistrimit të fermave apo regjistrave të tjerë administrative (përfshirë Censusin e Bujqësisë), nuk ka mundur zbatimin e metodologjive ndërkombëtare për realizimin e vrojtimeve statistikore për sektorin bujqësor. Megjithatë disa nga treguesit janë përlogaritur bazuar në të dhënat administrative.

Cilësia e të dhënave

Sigurimi i cilësisë është i rëndësishëm për çdo aktivitet dhe për çdo fazë operacionale të proceseve statistikore. Duke u bazuar në “Kodin e Praktikës” ai duhet të kuptohet si një koncept shumëdimensional, që përfshin dimensionet e mëposhtme: rëndësinë, plotshmërinë, saktësinë, krahasueshmërinë, lidhjen logjike, përpikmërinë në kohë dhe aksesueshmërinë.

INSTAT gjatë punës së tij është udhëhequr nga këto parime. Shihet si një mundësi dhe si sfidë e së ardhmes përpilimi i një dokumenti standart dhe të vetëm që të shërbejë si udhërfues për analizën e cilësisë së të dhënave statistikore, qofshin këto të dhëna administrative apo nga anketa të ndryshme.

Cilësia e të dhënave administrative

1. Në kuadër të statistikave vitale është vënë re një plotshmëri në informacionin e marrë dhe kjo është bërë e dukshme në plotësimin e informacionit për disa tregues të rëndësishëm demografikë. Megjithatë akoma ka vend për përmirësim sepse ka tregues ku plotshmëria e tyre lë për të dëshiruar, sidomos në lidhje me shkaqet e vdekjeve, të cilat mungojnë që prej vitit 2010. Gjithashtu për të gjitha të dhënat administrative, ekspertet e fushave kontrollojnë plotshmërinë, besueshmërinë dhe cilësinë e tyre.
2. Për vlerësimet e llogarive kombëtare përdoret një gamë e gjerë informacioni i siguruar nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative. Të dhënat e përdorura mund të jenë prodhim statistikor i vetë INSTAT ose i institucioneve të ndryshme kombëtare si Ministrinë, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe të tjera.
3. Gjatë vitit 2015 vëmendja u fokusua kryesisht në informacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT). Në mars 2015 u nënshkrua një marrëveshje e re, e rinovuar, në formën e një memorandumit mirëkuptimi ndërmjet Institutit të Statistikave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. DPT do të furnizojë INSTAT me të dhëna identifikuese dhe ekonomike në nivel ndërmarrje, duke bërë të mundur përmirësimin e cilësisë së statistikave zyrtare dhe prodhimin e indikatorëve të rinj.

4. Të dhënat administrative që përdor DAPF përse i përket treguesve të mbrojtjes sociale, ata kanë një cilësi të kënaqshme por nuk janë të harmonizuar me sistemin e statistikave të mbrojtjes sociale që kërkohet nga Eurostat (ESPROS). Shqipëria, ashtu si dhe vendet e tjera të rajonit ka vënë në plan implementimin e këtij sistemi që për vetë natyrën e tij kërkon përpjekje dhe bashkërendime intra dhe ndër-institucionale.

Cilësia e regjistrave

Burimi kryesor për mirëmbajtjen e regjistrit statistikor të ndërmarrjeve është regjistri i bizneseve. Në bashkëpunim me ekspertë të huaj dhe me sektorin e metodologjisë u përgatit një draft - Raport mbi Cilësinë e Regjistrit të Ndërmarrjeve, 2012 - 2013. Raporti u rishikua edhe nga bordi i Drejtorëve në INSTAT e më pas mori formën përfundimtare. Përgatitja e raportit të cilësisë së RSN do të jetë aktivitet vjetor.

Cilësia e të dhënave të anketave

Të gjitha anketat pranë familjeve të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2015, kanë si bazë zgjedhje rezultatet e Censurit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011. Të gjitha anketat pranë ndërmarrjeve të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2015, kanë si bazë zgjedhje Regjistrin Statistikor të ndërmarrjeve, 2014. Pavarësisht faktit se nuk ka një formë standarte të matjes së nivelit të cilësisë së të dhënave nga vërtetimet, sipas standarteve evropiane, INSTAT në faqjen e internetit përfshin informacione konceptuale dhe metodologjike për çdo temë statistikore, duke ndihmuar përdoruesin për të kuptuar dhe vlerësuar cilësinë e statistikave nga vërtetimet. Treguesit më kryesorë të cilësisë që llogariten janë: koeficienti i variacionit, gabimi standard, intervali i besimit për nivelin e besueshmërisë 95 %.

Në tabelën 2 jepen devijimet standarde dhe koeficientet e variacionit të shpenzimeve mesatare mujore për konsum sipas qarqeve për Anketën e Buxhetit të Familjes ² 2014.

Tabela 2 Treguesit e saktësisë së vlerësimeve për shpenzimet për konsum sipas qarqeve

	Vlerësimi i shpenzimeve për konsum	Devijimi standard	Intervali i besimit 95%		Koeficienti i Variacionit
			I poshtëm	I sipërm	
Shpenzimet mesatare gjithsej	69.442	760	67.953	70.931	1,1
Berat	59.855	2.517	54.919	64.79	4,2
Dibër	66.951	4.688	57.762	76.141	7,0
Durrës	68.083	3.567	61.091	75.076	5,2
Elbasan	53.013	2.179	48.742	57.285	4,1
Fier	68.721	1.867	65.061	72.381	2,7
Gjirokastrë	74.293	3.709	67.023	81.563	5,0
Korçë	57.633	2.241	53.24	62.026	3,9
Kukës	59.623	3.471	52.818	66.428	5,8
Lezhë	78.811	3.731	71.498	86.124	4,7
Shkodër	76.509	2.415	71.775	81.244	3,2
Tiranë	81.657	1.489	78.739	84.574	1,8
Vlorë	54.931	2.301	50.421	59.441	4,2

² <http://www.instat.gov.al/al/themes/konsumi-i-familjeve/publications/books/2015/anketa-e-buxhetit-te-familjes,-2014.aspx>

Ngarkesa e të Intervistuarve

Statistikat ekonomike përdorin vetëm një indikator për të vlerësuar numrin e pyetësorëve që ndërmarrjet sipas madhësisë, duhet të përgjigjen (Response burden).

Për të arritur një shpërndarje të barabartë të “response burden” për kryerjen e vërtetimit merret në studim një kampion i zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve. Kampionet e vërtetimit të kryera nuk janë të koordinuara me njëra tjetrën, por lista e ndërmarrjeve me mbi 10 të punësuar vërtetohet rregullisht në çdo anketë sipas aktiviteteve që mbulon anketa.

Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes për vitin 2015, duke marrë në konsideratë gjithë vërtetimet pranë ndërmarrjeve ekonomike që INSTAT realizon, jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3 Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes

Nr	Madhësia e ndërmarrjes	0 pyetësorë	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11+ pyetësorë
1	1_9 pun.	91916	14201	175	67
2	10_19 pun.	502	1612	522	122
3	20_49 pun.	563	643	457	215
4	50+ pun.	484	228	327	438

Figura 1 Përqindja e shpërndarjes së pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes



Në grupin e ndërmarrjeve të vogla (1-9 të punësuar) ku është i përqendruar numri më i madh i ndërmarrjeve të vendit, pjesa më e madhe e tyre rreth 86,4 % , nuk kanë për të plotësuar asnjë pyetësor, 13,4 % kanë për të plotësuar 1 deri në 5 pyetësorë dhe vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre (më pak se 1%) ngarkohen me mbi 5 pyetësorë. Siç shikohet nga grafiku, në grupin e ndërmarrjeve me 20 deri 49 të punësuar, 64,2 % e tyre ngarkohen deri në maksimumi 5 pyetësorë për t'u përgjigjur dhe vetëm 35,8 % e tyre ngarkohen me mbi 5 pyetësorë. Ngarkesa e përgjigjes është relativisht e lartë në grupin e ndërmarrjeve me 50 të punësuar e lart ku rreth 67,2 % e tyre duhet t'u përgjigjen të paktën 1 pyetësori.

II. **Statistikat pranë familjeve** përdorin dy tregues për të vlerësuar “Ngarkesën e të intervistuarve”: Numrin e pyetësorëve që INSTAT i dërgon familjeve për t'u përgjigjur dhe kohëzgjatjen e intervistës. Gjatë vitit 2015 INSTAT ka realizuar anketat e mëposhtme pranë familjeve :

- Anketën e Forcave të Punës
- Anketën e Buxhetit të Familjes
- Anketën “Besimi i Konsumatorit” (për Bankën e Shqipërisë)
- Anketën “Borxhi i Familjeve” (për Bankën e Shqipërisë)
- Anketa e Instrumentave të Pagesës së Individëve (për Bankën e Shqipërisë)
- Anketa e Instrumentave të Kulturës Financiare (për Bankën e Shqipërisë)

Anketat e kryera pranë familjeve në Shqipëri kanë si karakteristikë faktin që mbledhin informacion mbi karakteristika të familjeve dhe individëve që nuk gjenden në regjistra apo rekorde administrativë. Si rrjedhim, përpjekjet për të ulur shkallën e rëndësës janë fokusuar në lehtësirat që mund t'i krijohen familjeve përsa i përket kuptueshmërisë dhe rëndësisë së informacionit, aplikimit të formave elektronike që shkurtojnë kohën dhe automatizojnë administrimin e intervistimit si dhe përpjekjeve për të regjistruar dhe para-printuar atë pjesë të informacionit që mund të jetë i disponueshëm.


Të gjitha anketat pranë familjeve të realizuar nga INSTAT përgjatë vitit 2015 kanë si bazën e tyre të zgjedhjes rezultatet e Censusit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011. Në vitin 2015, janë anketuar rreth 2,8 % Njësi Ekonomike Familjare (NjEF) nga 722.262 të regjistruara në Census. Janë intervistuar gjithsej 20.104 NJEF nga të cilat 98,8 % e tyre kanë marrë pjesë vetëm në një vrojtim ndërsa 1,2 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 vrojtme të realizuar nga

INSTAT pranë familjeve gjatë vitit 2015. Shpërndarja e numrit të vrojtimeve sipas qarqeve për vitin 2015, duke marrë në konsideratë të gjitha vrojtimit pranë familjeve që realizon INSTAT, jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4 Shpërndarja e numrit të vrojtimeve sipas qarqeve

Qarku	Asnjë vrojtim	Një vrojtim	Dy vrojtime	Numri i NjEF për Qark
Berat	37.409	1.065	19	38.493
Dibër	28.796	756	21	29.573
Durrës	64.722	1.904	25	66.651
Elbasan	71.025	1.993	26	73.044
Fier	79.821	2.267	13	82.101
Gjirokastrë	20.516	733	12	21.261
Korçë	58.461	1.687	23	60.171
Kukës	16.617	496	13	17.126
Lezhë	31.311	916	10	32.237
Shkodër	52.822	1.583	22	54.427
Tiranë	191.19	4.971	56	196.217
Vlorë	49.468	1.488	5	50.961
GJITHSEJ	702.158	19.859	245	722.262

Figura 2 Ngarkesa e përgjigjes për NjEF-ve




Anketat e kryera pranë familjeve në Shqipëri kanë si karakteristikë faktin që mbledhin informacion mbi karakteristika të familjeve dhe individëve që nuk gjenden në regjistra apo rekorde administrativë. Si rrjedhim, përpjekjet për të ulur shkallën e rëndesës janë fokusuar në lehtësirat që mund t'i krijohen familjeve përsa i përket kuptueshmërisë dhe rëndësisë së informacionit, aplikimit të formave elektronike që shkurtojnë kohën dhe automatizojnë administrimin e intervistimit si dhe përpjekjeve për të regjistruar dhe para-printuar atë pjesë të informacionit që mund të jetë i disponueshëm.

Dy anketat e kryera pranë familjeve në vitin 2015 ishin:

1) Anketa e Buxhetit të Familjes me një kampion prej 9.024 familjesh dhe një shkallë mos-përgjigjeje prej 18,2 % për vitin 2015 e cila konsiston në dy mënyra intervistimi: vetë-plotësimi për 14 ditë i fletores së shpenzimeve të përditshme të konsumit nga NjEF dhe intervistë direkte nëpërmjet anketuesit me pyetësorin e Intervistës Finale ku merren shpenzimet më të mëdha dhe më pak frekvente.

Figura 3 Përqindja e familjeve sipas kohëzgjatjes së intervistës finale, ABF 2015



2) Anketa e Forcave të Punës mbështetet në modelin e zgjedhjes të panelit të alternuar, përmes së cilës një familje e zgjedhur për t'u intervistuar njëherë, mbahet në anketë për pesë tremujorë të njëpasnjëshëm. Kjo lloj strukture paneli mbart riskun e rritjes së barrës së familjes dhe individëve që janë pjesë e anketës. Në tre tremujorët e parë të vitit 2015 kanë qënë përzgjedhur 18.600 familje me një tregues mospërgjigjeje 12,6 %. Për të ulur barrën e familjeve dhe individëve të AFP, për familjet e intervistuar në valën e parë në aplikacionin e hedhjes së të dhënave në laptop ruhet i para-plotësuar informacioni demografik dhe në valët pasardhëse anketuesi verifikon vetëm nëse ka ndryshime në numrin e anëtarëve të familjes dhe nëse ka ndryshime në statusin martesor, etj.

Një mënyrë që mund të gjejë aplikim në të ardhmen, lidhur me uljen e ngarkesës së familjeve për këtë anketë është “Metoda e ndërthurur” ku vala e parë mund të kryhet me intervistë direkte (CAPI) dhe valët nga 2 në 5 mund të kryhen me intervistë telefonike (CATI).

Analiza SWOT

Me anë të analizës SWOT synohet të paraqiten pikat e forta dhe të dobëta të cilat kanë përmirësuar apo penguar punën e stafit dhe arritjen e objektivave të INSTAT.

Në të njëjtën kohë prezantohen edhe oportunitetet dhe kërcënimet që vijnë nga mjedisi jashtë Institucionit.

1. Fuqitë:

- Legjislacion i veçantë
- Indentit tashmë i krijuar
- Lidhje të forta ndërsektoriale brenda dhe jashtë INSTAT
- Staf të motivuar, profesional dhe me njohuri në statistikë dhe në gjuhë të huaja
- Përdorim të klasifikimeve ndërkombëtare
- Standarde metodologjike në përputhje me rekomandimet e Eurostatit-it
- Bashkëpunimi me ekspertë të huaj ka rritur profesionalizmin e stafit si dhe ka zhvilluar mënyrën e të punuarit dhe gjykuarit

2. Dobësitë

- Legjislacioni duhet forcuar në disa fusha, si ajo e varësisë së INSTAT
- Nivel jo i njëjtë pagash për stafin në krahasim me institucionet e tjera
- Mungesa e personave të referencës në institucionet që janë burim i të dhënave administrative
- Mungesa e analizave dhe interpretimeve më të thelluara të treguesve
- Mungesa e strategjisë së shpërndarjes së të dhënave
- Mungesa e një sektori të veçantë për studimin e cilësisë së treguesve statistikorë
- Informatizimi i metejshëm i procesit të shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve

3. Oportunitete

- Rritja e gamës së indikatorëve të prodhuar nëpërmjet përdorimit maksimal të informacionit administrativ ekzistues, duke rritur dhe përforcuar bashkëpunimin me institucionet e jashtme
- Projekte të tilla si SIDA apo IPA do t'i mundësojnë INSTAT një zhvillim të statistikave në fusha të ndryshme.
- Forcimi akoma më shumë i identitetit të INSTAT

4. Kërcënimet

- Mungesa e burimeve financiare për realizimin e PSZ
- Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet agjencive të ndryshme do të sillte vonesa në realizimin e PSZ
- Mos plotëshmëria e disa variablave në të dhënat e eventeve demografike, transmetuar nga DPGJC sidomos ajo e shkaqeve të vdekjeve.
- Mosunifikimi i suportit të të dhënave administrative të njësive statistikore (ndërmarrje, institucione, etj.), ndikon në ngarkesën e specialistëve të Llogarive Kombëtare dhe të IT.

Aksione të reja statistikore gjatë vitit 2016

INSTAT në programin e tij statistikor vjetor parashikon kryerjen e aktiviteteve të reja në vazhdimësi, si më poshtë:

I. Prodhimi i statistikave të reja

1. Të rritim shkallën e përdorimit të të dhënave administrative, kryesisht në fushën e migracionit (Imigrantët, azilantët) si dhe të aborteve duke marrë në konsideratë informacionin e mbledhur nga skeda e abortit
2. Shtimi i tabelave të reja në publikimin e rradhës “Femra dhe Meshkuj” me të dhëna për kreditë dhe patentat e marra sipas gjinisë.
3. Kryerja e analziave të thelluara me tematikë të cilat do të përcaktohen nga sektori dhe drejtorja si dhe drejtori të tjera të përfshira në furnizimin me të dhëna por dhe të interesuara për tema të veçanta.
4. Ndërtimi i një sistemi statistikor për statistikat e kulturës në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës.
5. Rritja e shkallës së përdorimit të të dhënave administrative, kryesisht në fushën e shëndetësisë dhe arsimit.
6. Implementimin e klasifikimit të veprimtarive ekonomike NVE Rev2 dhe metodologjisë ESA 2010 në serinë e të dhënave të PBB-së për vitet 1996-2007.
7. Implementimin e klasifikimeve të veprimtarive ekonomike NVE Rev2 dhe produkteve NP 2008 në Tabelat e Burime-Përdorimeve 2009-2012.
8. Prodhimin e statistikave të llogarive kombëtare sipas sektorëve institucionale.
9. Unifikimi i klasifikimeve të shëndetësisë dhe arsimit. (ICD-10 dhe ISCED-2011) nga ministritë e linjës.
10. Në bashkëpunim me ekspert suedez nga statistikat e Suedisë (SCB) po punohet për të krijuar një aplikacion/ndërfaqe e cila do të integrohet me bazën e të dhënave (data model) të regjistrit të ndërmarrjeve dhe regjistrit të njësive lokale. Ky aplikacion do të shërbejë për mirëmbajtjen e regjistrave të njësive ekonomike dhe përditësimin automatik të tyre si dhe do të thjeshtësojë e optimizojë punën lidhur me kërkesat e sektorëve të tjerë. Të dhënat për 2013 janë ngarkuar në sistem dhe do testohet përditësimi automatik për RSN 2014.
11. Llogaritja e çmimeve të imputeve bujqësore.
12. Numri i kafshëve që theren në thertore dhe pesha e therur.

13. Sasia e qumështit që fermerët shesin direkt në industri dhe prodhimi i nënprodukteve të qumështit sipas nomenklaturës së produkteve PRODCOM dhe përmbajtjes së % së yndyrës dhe proteinave.

II. Kryerja e vrojtimeve të reja mbi:

1. Treguesit e shoqërisë së informacionit
2. Treguesit e Inovacionit
3. Vrojtimi pilot mbi “Të mësuarit gjatë gjithë jetës”
4. Numrin e kafshëve që theren në thertore dhe pesha e therur
5. Sasinë e qumështit që fermerët shesin direkt në industri dhe prodhimi i nënprodukteve të qumështit sipas nomenklaturës së produkteve PRODCOM dhe përmbajtjes së % së yndyrës dhe proteinave
6. Prodhimin i vezëve në agroindustri dhe fermat me pulari për konsum të popullatës;
7. Vrojtimi statistikor për matjen e Cilësisë së Regjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve i cili do të zëvendësojë ANR
8. Përdorimi i lëndës drusore për energji

III. Aktivitete mbështetëse

1. Rishikimi i planifikimit të buxhetit 2016-2018;
2. Miratimi i projekt-strukturës organizative të INSTAT-it dhe ndjekja e procedurave për plotësimin e saj me burimet njerëzore të nevojshme;

Gjithashtu INSTAT ka parashikuar edhe vendosjen në faqen web të një aplikacioni i cili do të lehtësojë punën për llogaritjen e ndryshimit të çmimeve të konsumit nga përdoruesit.

Mjete dhe produkte të reja për përdoruesit

Aplikacioni mobile “Publikime INSTAT” mundëson përdoruesit të njoftohen në kohë reale mbi publikimet e Institutit të Statistikave (INSTAT) dhe ti shkarkojnë ato në pajisjet e tyre mobile. Gjithashtu, përdoruesit mund të regjistrohen në fushat statistikore që ju interesojnë për të marrë në kohë reale publikimet që lidhen me to. Aplikacioni mobile përmban listën e publikimeve, listën e publikimeve sipas temave, listën e librave të publikuar, mundësinë e kërkimit të publikimeve, mundësinë e regjistrimit për të marrë në kohë reale njoftime mbi publikimet e reja si edhe mundësinë e kontaktimit me INSTAT.

Duke ndjekur shembullin e instituteve të tjera statistikore, INSTAT vendosi të ndërmarrë nismën e krijimit të një aplikacioni mbi statistikën e emrave. Aplikacioni (i cili është ndërtuar me gjuhën e programimit R), shfrytëzon dy burime kryesore të dhënash: baza e të dhënave të Census-it të Popullsisë dhe Banesave në vitin 2011 dhe baza e të dhënave të Gjendjes Civile me të dhënat administrative të lindjeve nga viti 2011 deri në 2014.

Organizimi i punës dhe implementimi i një procesi të ri prodhimi

Gjatë viti 2015, janë përdorur për herë të parë tabletët, për procesin e mbledhjes së të dhënave në terren, për anketën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Përdorimi i tabletave eliminon procesin e hedhjes së të dhënave nga pyetësit letër në sistem, gjithashtu mundëson ekzekutimin e një bashkësie kontrollesh, rregullash logjike gjatë intervistës, gjë që lehtëson shumë procesin e mëposhëm të pastrimit të të dhënave.

Mbledhja online e të dhënave të anketave, si një mënyrë me kosto më të ulët të mbledhjes së të dhënave, duke shmangur përdorimin e anketuesve, si edhe duke i krijuar lehtësinë njësisë së anketuar për t'u përgjigjur me privatësi dhe në kohën më të përshtatshme për të, është akoma në fazë pilot. Janë mbledhur online të dhënat për ndërmarrjet më të mëdha, pjesë e kampionit të anketës Tremujore pranë Ndërmarrjeve.

Burimet njerëzore dhe financiare

Burimet njerëzore

Viti 2015 e gjeti Institutin e Statistikave me një kuadër ligjor të kompletuar përsa i përket menaxhimit të nëpunësve civilë të institucionit (Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar” dhe një sërë aktesh nënligjore në zbatim të tij). Ana menaxheriale e burimeve njerëzore për vitin 2015, është fokusuar në disa drejtime kryesore si më poshtë:

- Procesi i hartimit të përshkrimeve të punës konform strukturës së re bazuar në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 126, datë 10.09.2015 “Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Institutit të Statistikave”. Për rregullim e këtij detyrimi ligjor është punuar me kujdes nën udhëzimin e vazhdueshëm të DAP-it për të gjitha pozicionet e strukturës dhe plotësimin e tyre.
- Procesi i menaxhimit të vlerësimit 6-mujor dhe vjetor për punonjësit në periudhë prove dhe me status. Ky proces përfshiu disa faza: menaxhim të procesit të vlerësimit të punonjësve të INSTAT në periudhë prove, konform Ligjit Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM Nr. 109, datë 26.2.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, si për stafin e INSTAT Qendër ashtu dhe për Zyrat rajonale dhe menaxhimin e procesit të trajnimit në ASPA për punonjësit në periudhë prove konform VKM Nr. 143, datë 12.3.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.
- Procesi i perfaqësimit të institucionit në çështjet administrative dhe civile gjyqësore të ngritura.
- Procesi i menaxhimit të procedurave të prokurimit në përputhje me regjistrin e parashikimeve hartuar në funksion të nevojave të aktiviteteve të çdo sektori.
- Kontraktimi i punonjësve me kohë të pjesshme, që zhvillohen periodikisht ose jo nga INSTAT. Puna konsiston në përgatitjen e kontratave të punës dhe kontratave të shërbimit, në respekt të Udhëzimit të përbashkët me Ministrinë e Financave për punonjësit me kontratë. Tabela në vijim paraqet një informacion të përgjithshëm mbi

llojin e vrojtimit statistikor, periodicitetin e zbatimit të tij dhe numrin e stafit mbështetës të angazhuar:

Tabela 5 Punonjësit e angazhuar me kohë të pjesshme

Nr.	Lloji vrojtimit	Periodiciteti/për vitin 2015	Stafi mbështetës për anketë (+/-5%)
1	Indeksi Çmimeve të Importit (IÇI) dhe Kushtimi në Ndërtim (IÇK), (IÇP)	tremujor	44
2	Anketa pranë Ndërmarrjeve të Reja (ANR)	katërmujor	35
3	Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve (ASN)	vjetor	116
4	Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve (ATN)	tremujor	44
5	Besimi i Biznesit	tremujor	34
6	Borxhi i Ndërmarrjeve, Besimi Biznesit, Turizmi	gjashtëmujor	78
7	Anketa e Forcave të Punës	vjetor	56
8	Investimet e Huaja Direkte (FDI) Matja e kostos së Instrumenteve për Bizneset	tremujor	38
9	Anketa Fondi i pensionit Profesional	një herë në vit	30
10	Anketa e Buxhetit të Familjeve (ABF)	vjetor	70
11	Anketa e Njësive Lokale (ANJL)	katërmujor	93
12	Indeksi i Kushtimit në Ndërtim për Punimet Inxhinierike	një herë në vit	6
13	Vrojtimi i çmimeve të produkteve bujqësore, vrojtimi i aktiviteteve të thertoreve, vrojtimi i vezëve në pulari, raporti mujor i qumështit të grumbulluar dhe produkteve të prodhuara	vjetor	14
14	Anketa Turizmit	tremujor	39
15	Anketa pasuritë e paluajtshme	gjashtëmujor	37
16	Anketa e Kostos të Instrumentave të Pagesave për Individët	gjashtëmujor	51
17	Anketa Besimi i Konsumatorit	tremujor	39
18	Mbetjet Urbane dhe Industriale	vjetor	38
19	Anketa e Matjes së Kulturës Financiare të Popullatës	vjetor	50
20	Anketa TIK	vjetor	44
21	Anketa e Borxhit të Familjeve	gjashtëmujor	38
22	Anketa Matja e Kostos së Instrumentave për Bizneset	gjashtëmujor	38
23	Anketa e grumbullimit të qumështit	një herë në vit	35


Në fund të vitit 2015, INSTAT kishte 191 punonjës ndaj 235 pozicioneve të strukturës. Kjo ka ardhur kryesisht si pasojë e pamundësisë së rekrutimit të personelit nga INSTAT si dhe për arsye të miratimit të strukturës së re organizative të institucionit, në muajin Shator 2015. Sipas ligjit të

ri për nëpunësin civil, procedurat e rekrutimit dhe emërimit të nëpunësve civilë për INSTAT kryhen nga Departamenti i Administratës Publike.

Tabela 6-Numri i punonjësve të INSTAT, sipas gjinisë

Vitet	Gjithsej	Meshkuj	Femra
2015	191	56	135
2014	217	57	160
2013	218	58	160
2012	173	40	133


Figura 4 Përqindja e punonjësve të INSTAT sipas gjinisë



Ashtu si edhe në vitet e mëparshme, stafi i INSTAT-it përbëhet kryesisht nga gjinia femërore. Megjithatë, pas plotësimit të strukturës organizative të vitit 2013, kjo dominancë ka ardhur duke u reduktuar. Përqindja e vendit që zenë femrat është 70,7 % kundrejt meshkujve me 29,3 %.

Tabela 7-Punonjësit e INSTAT sipas grupmoshës për vitin 2015

Grupmosha	Numri i Punonjësve
Deri 25 vjeç	6
25-34 vjeç	76
35-44 vjeç	35
45-54 vjeç	39
55-64 vjeç	35
Gjithsej	191


Figura 5 Përqindja e punonjësve të INSTAT sipas grupmoshës

Në INSTAT janë të punësuar rreth 39.8% nëpunës të rinj të cilët zënë pjesën më të madhe të stafit nga mosha 25-34 vjeç.

Tabela 8 Punonjësit sipas viteve të punës në INSTAT për vitin 2015

Vitet e punës në INSTAT	Numri i Punonjësve
0 deri në 1 vit	7
1 deri në 2 vjet	12
3 deri në 4 vjet	38
5 deri në 9 vjet	58
Mbi 10 vjet	76
Gjithsej	191

50,3 % e stafit ka 3-9 vjet që punon në institucion gjë që garanton qëndrueshmërinë e zbatimit të aktiviteteve sipas standardeve të kërkuara statistikore.

Figura 6 Përqindja e të punësuarve në INSTAT sipas viteve të punës**Burimet Financiare**

INSTAT është institucionin publik qendror, në varësi të Kryeministrit. Burimet e financimit për kryerjen e aktivitete statistikore dhe atyre mbështetëse sigurohen kryesisht nga buxheti i shtetit. Ndikim domethënës kanë edhe financimet e huaja nëpërmjet donatorëve apo granteve të alokuara, si dhe të ardhurat dytësore apo fondet jashtë limitit, të cilat sigurohen nga veprimtaritë dytësore që kryen INSTAT.

Në periudhën Janar-Shkurt 2015 është punuar për mbylljen e vitit ushtrimor 2014 dhe përgatitjen e Bilancit të vitit 2014 për Aparatin Qendror INSTAT. Kjo detyrë u realizua brenda afateve të përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë së Financave, duke depozituar një kopje në Degën e Thesarit.

Në periudhën Prill 2015 është punuar për përgatitjen e Bilancit përmbledhës të vitit 2014 për Aparatin Qendror INSTAT dhe Zyrat Rajonale në Rrethe duke depozituar një kopje në Ministrinë e Financave.

Në bashkëpunim me drejtoritë dhe sektorët e tjerë të institucionit, u përgatit projekt-buxheti afatmesëm 2016-2018, sipas fazave të parashikuara nga aktet nënligjore duke i dorëzuar brenda afateve të kërkuara.

Detajimi i buxhetit të vitit 2015, është propozuar nga INSTAT dhe miratuar nga Ministria e Financave, për Aparatin Qendror dhe Zyrat Rajonale të Statistikave. Në muajin Dhjetor 2015

është hartuar detajimi i buxhetit të vitit 2016 për Aparatin Qendror dhe Zyrat Rajonale të Statistikave. Është bërë përditësimi çdo muaj me librin e pagave për punonjësit në strukturë dhe punonjësit me kontratë pune me kohë të pjesshme mbi 6 muaj.

Tabela 8 Detajimi i buxhetit të INSTAT, 2011-2015

		FAKT				
Art	SHPENZIMET	2011	2012	2013	2014	2015
	Paga + kontribut	187,977.00	275,973.00	231,327.80	278,819.00	280,366.00
	Mallra dhe shërbime të tjera	166,301.00	118,128.00	59,070.50	60,091.00	57,574.80
	Totali operative	354,278.00	394,101.00	290,398.30	338,910.00	337,940.80
	Investime	333,069.00	22,215.00	2,997.20	6,927.00	6,401.00
1	TOTALI BUXHETI	687,347.00	416,316.00	293,395.50	345,837.00	344,341.80
	Paga + kontribut	13,428.00	12,646.00	12,941.70	14,055.00	6,518.00
	Mallra dhe shërbime të tjera	421.00	645.00	102.90	44.00	7,954.00
	Totali operative	13,849.00	13,291.00	13,044.60	14,099.00	14,472.00
	Investime	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2	TOTALI nga të ardhurat	13,849.00	13,291.00	13,044.60	14,099.00	14,472.00
	Paga + kontribut	187.00	336.00	1,146.00	527.00	870
	Mallra dhe shërbime të tjera	1,795.00	4,710.00	11,610.00	4,949.00	4620
	Totali operative	1,982.00	5,046.00	12,756.00	5,476.00	5,490.00
	Investime			328.00		
3	Te ardhura jashtë limiti	1,982.00	5,046.00	13,084.00	5,476.00	5,490.00
	Paga + kontribut	25,185.00	61,106.00	8,514.00	4,558.00	723.00
	Mallra dhe shërbime të tjera	681,471.00	312,073.00	61,143.00	98,905.00	15,899.00
	Totali operative	706,656.00	373,179.00	69,657.00	103,463.00	16,622.00
	Investime	822.00	14,266.00	400.00		2,769.00
4	Te ardhura nga donatorë	707,478.00	387,445.00	70,057.00	103,463.00	19,391.00
	Paga + kontribut	226,777.00	350,061.00	253,929.50	297,959.00	288,477.00
	Mallra dhe shërbime të tjera	849,988.00	435,556.00	131,926.40	163,989.00	86,047.80
	Totali operative	1,076,765.00	785,617.00	385,855.90	461,948.00	374,524.80
	Investime	333,891.00	36,481.00	3,725.20	6,927.00	9,170.00
	TOTALI	1,410,656.00	822,098.00	389,581.10	468,875.00	383,694.80


Janë përpiluar në periudha të ndryshme listëpagesat e pagave, listëpagesat e sigurimit shoqëror për 3.915 punonjës me kontratë për anketat e Bankës së Shqipërisë, të buxhetit të shtetit dhe nga donatorë të huaj si dhe janë hedhur në sistem online.

Për vitin 2015 janë shpenzuar rreth 384 milion lekë.

Siç shihet nga grafiku i mëposhtëm, volumin kryesor të shpenzimeve në vite e zë pjesa e pagave të stafit të INSTAT-it dhe ajo e personave të kontraktuar me kohë të pjesshme.

Për shkak të natyrës së punës që ka institucioni, pjesën kryesore të shpenzimeve e zënë pagat e personelit me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore të tyre.

Figura 7 Shpërndarja e shpenzimeve për vitin 2015



Instituti të Statistikave për vitin ushtrimor 2015 i janë akorduar nga buxheti i shtetit **384.870 mijë lekë**. Këto fonde INSTAT i administron në një program “Veprimtaria Statistikore”.

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave për vitin 2015, krahasuar me planin vjetor paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Tabela 9 Realizimi i shpenzimeve JANAR – DHJETOR 2015

Mijë/lekë

		2015		%
Art	SHPENZIMET	PL Vjetor	Fakt	REALIZIMI
600	Shpenzime personeli	290,900.00	286,884.00	98,62
602	Shpenzime të tjera korrente	70,778.40	65,528.80	92,58
	Totali shpenzimeve korente	361,678.40	352,412.80	97,44
231	Shpenzime kapitale të brendshme	23,192.00	6,401.00	27,60
	TOTALI	384,870.40	358,813.80	93,23

Siç shihet nga të dhënat e tabelës, plani i shpenzimeve të buxhetit në artikullin 600 “Shpenzime personeli”, i cili zë rreth 75 % të tij, është realizuar në masën 98,6 %.

Në artikullin 602 “Shpenzime të tjera korrente” është realizuar në masën 92,6 %.

Në artikullin 231 “Shpenzime për investime” është realizuar 27,6 %. Realizimi i ulët është shkaktuar si rrjedhojë e mospërdorimit të fondeve TVSH të cilat ishin të destinuara si pjesë e kontributit të shtetit shqiptar në kuadër të projektit grant nga qeveria suedeze “Zhvillimi i infrastrukturës IT dhe ngritja e qendrës së trajnimit për INSTAT”. Duke qenë se marrëveshja për projektin është nënshkruar në muajin Dhjetor 2015, për rrjedhojë fondet për TVSH nuk janë përdorur.

Shpenzimet gjithsej janë realizuar në masën 93.2% në krahasim me planin vjetor.

Tabela 10 Shpenzimet në Veprimtarinë statistikore

	SHPENZIMET në Mijë/lekë	Plani	Fakti	% Realizimit
	Veprimtaria Statistikore	384,870.4	358,813.80	93,23
	Të ardhura jasht limitit		5,489.6	
	TOTALI	384,870.4	364,303,9	94,65

Shpenzimet e realizuara nga të ardhurat jashtë limitit janë 5,490 mijë lekë.

Integrimi Evropian dhe Koordinimi i Projekteve

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar statistikor gjatë 2015 është komunikuar me zyrën e statistikave evropiane Eurostat, veçanërisht me Njësinë A3 për Bashkëpunimin Statistikor, për çështje të bashkëpunimit statistikor dh në kuadër të raportimit për progresin e sistemit statistikor kombëtar dhe pajtueshmërinë me standardet e Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane në prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare, etj.

Gjithashtu, janë mbajtur kontakte me Divizionin e OKB-së për Statistikat, Delegacionin e Bashkimit Evropian në Tiranë, FMN, ILO, BB, UNECE, OECD, SESRIC, dhe gjithë agjencitë e OKB-së në Shqipëri në kuadër të dhënies së kontributit dhe raportimit/monitorimit të treguesve të zhvillimit rajonal dhe global.

Në kuadër të procesit të integrimit evropian, INSTAT ka kryer një sërë aktiviteteve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e punës së Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 18. Statistikat. Gjatë vitit 2015 është përgatitur përditësimi për çdo 4 muaj i materialit të kapitullit 18, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. INSTAT ka përgatitur kalendarin e legjislacionit të BE-se që duhet të përkthehen nga gjuha angleze në gjuhën shqipe për vitin 2015, përditësimin e raportimit të zbatimit të rekomandimeve të nënkomitetit Ecofin 2014, përditësimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për kapitullin 18, ku INSTAT është edhe koordinator por edhe për kapitujt e tjerë ku INSTAT kontribuon sipas fushës së kompetencës.

Në përputhje me Udhëzuesin për Hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, INSTAT ka dhënë inputet e veta për përditësimin e PKIE 2016-2018 në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze duke koordinuar punën me strukturat teknike të INSTAT si dhe me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave për mbledhjen dhe përgatitjen e informacionit.

Zyra statistikore e Bashkimit Evropian (Eurostat), ndjek progresin e vendeve kandidate dhe kandidate potenciale në lidhje me pajtueshmërinë e sistemeve kombëtare statistikore me acquis në fushën e statistikave si dhe grumbullon të dhëna nga këto vende. Një nga instrumentat e Eurostat për monitorimin e progresit të sistemit kombëtar statistikor të vendeve të zgjerimit është edhe kryerja e misionëve të vlerësimit të tilla si Adapted Global Assessment (AGA) dhe Light Peer Reviews (LPR) si edhe Vlerësime Sektoriale të fushave statistikore specifike.

Në kuadër të këtyre monitorimeve, në datat 13 – 16 Korrik 2015, në INSTAT u zhvillua misioni i vlerësimit të zbatimit dhe pajtueshmërisë së punës së autoriteteve të sistemit statistikor në Shqipëri me standardet e parimeve të Kodit të Praktikës së statistikave evropiane.

Objekti i këtij misioni vlerësimi të kryer, është të kontribuojë në forcimin e integritetit, pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve statistikore, pjesë e Sistemit Kombëtar të Statistikave në Shqipëri, vlerësimi i efektivitetit të bashkëpunimit ndërinstitutional, zbatimi në praktikë i rolit të INSTAT si koordinator i sistemit kombëtar statistikor, mjedisi institucional, disponibiliteti, aksesimi dhe përdorimi i burimeve dhe regjistrave administrative, kuadri i cilësisë së të dhënave statistikore, etj.

Në rolin e Koordinatorit të Sistemit Kombëtar Statistikor, INSTAT ka realizuar komunikimin zyrtar midis Eurostat, Këshillit të Statistikave dhe Agjensive Kombëtare Statistike si Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë për kryerjen me sukses të misionit. Raporti përfundimtar i këtij misioni është bërë publik për të gjithë të interesuarit³. INSTAT së bashku me Agjensitë Statistike Zyrtare do të ndjekin zbatimin e rekomandimeve të këtij misioni dhe përmbushjen e tyre.

Si pjesë e Vlerësimeve Sektoriale nga Eurostat, gjatë periudhës 8-11 qershor 2015, në INSTAT u zhvillua misioni i vlerësimit për rishikimin e statistikave të biznesit në Shqipëri, pajtueshmërinë e prodhimit dhe shpërndarjes së këtyre statistikave me parimet e Kodit të Praktikës dhe standardeve evropiane. Në përfundim të misionit ekipi i ekspertëve ka paraqitur raportin e misionit me rekomandimet përkatëse të cilat do të ndiqen për zbatim nga INSTAT dhe institucione të tjera shqiptare me qëllim përmbushjen e tyre.

Eurostat dhe EFTA në bashkëpunim me INSTAT në kuadër të aktiviteteve për rritjen e njohurive dhe kapaciteteve të institucioneve statistikore të vendeve të zgjerimit dhe jo vetëm, për zbatimin e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, në 2-3 Korrik 2015, me pjesëmarrje nga vendet e rajonit por edhe shtete të tjera, organizuan në Durrës Workshopin me tematikë

³ <http://ec.europa.eu/eurostat/web/enlargement-countries/publications/reports>

“Kodi i Praktikës të Statistikave Evropiane”. Qëllimi i aktivitetit ishte shqyrtimi në mënyrë të detajuar i parimeve të këtij kodi dhe treguesve përkatës për të matur zbatimin e tyre nga zyrat e statistikave kombëtare dhe sistemet e tyre të statistikave.

Në vijim të punës së nisur nga INSTAT në bashkëpunim me Eurostat, Delegacionin Evropian në Tiranë për institucionalizimin e një binjakëzimi të INSTAT me një institut të një vendi evropian, më datë 17 Qershor 2015, në Gjenevë, gjatë zhvillimit të Konferencës së Statisticienëve Evropianë (CES) me prezencën edhe të Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të Eurostat Znj. Mariana Kotzeva, INSTAT dhe Zyra qendrore e Statistikave të Irlandës (CSO) nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi. Ky bashkëpunim do të shërbejë si një orientim strategjik për INSTAT drejt përmbushjes së standardeve statistikore evropiane duke konsoliduar me tej bashkëpunimin në forma të tjera të ndihmës dhe shkëmbimit të eksperiencave dhe dijeve.

Në kuadër të bashkëpunimit statistikor për përfaqësimin e INSTAT në forumet ndërkombëtare statistikore gjatë vitit 2015, Shqipëria është bërë pjesë e Iniciativës PARIS21 (Partneriteti në Statistika për Zhvillimin në shekullin e 21-të), një platformë ndërkombëtare e bashkëpunimit statistikor nëpërmjet anëtarësisë së Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT në Bordin e kësaj iniciative, duke kontribuar në politikat më elitare në fushën e statistikave në nivel ndërkombëtar. Në vijim të këtij bashkëpunimi, me financim të PARIS21, në datat 17-19 Nëntor, organizua në Tiranë workshopi mbi “Shpërndarjen e rezultateve të të dhënave statistikore”. Me pjesëmarrje nga ekspertë të EUROSTAT, OECD-së, ekspertë të Paris 21, të Kompanisë prestigjioze Positium me qendër në Estoni dhe përfaqësues të zyrave statistikore nga vendet në zgjerim si dhe nga vendet e Europës Juglindore.

Përfaqësues të INSTAT morën pjesë dhe kontribuan me prezantime në takimin e përvitshëm të strukturave të menaxhimit të bashkëpunimit statistikor të BE-së dhe të vendeve të zgjerimit respektivisht të Grupit të Menaxhimit për Bashkëpunimin Statistikor (MGSC).

Në datat 15-17 Qershor në Gjenevë, Zvicër u zhvillua Sesioni plenar i 63-të i Konferencës së Statisticienëve Evropian (CES) të Komisionit Ekonomik të OKB për Evropën (UNECE) ku INSTAT u përfaqësua nga niveli i lartë i menaxhimit.

INSTAT jep kontributin e Shqipërisë në zhvillimin e statistikave të paaftësisë nëpërmjet Anëtarësisë në Grupin e Washingtonit për Statistikat e Paaftësisë. Në muajin Gusht 2015 INSTAT konfirmoi edhe njëherë përfaqësuesin e institucionit në këtë organizim.

Kështu gjatë vitit 2015, INSTAT ka patur në zbatim disa projekte kryesisht me financim të Bashkimit Evropian nga IPA kombëtarë dhe nga IPA me shumë vende përfituese (IPAMB), Qeveria Suedeze dhe Qeveria Zviceriane.

Në zbatim të kuadrit ligjor për menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, (VKM nr. 707, datë 21.08.2013 dhe VKM nr. 541 datë 18.06.2015), INSTAT ka krijuar strukturën e Zyrtarit të Lartë të Programit (Senior Programme Officer), për menaxhimin e fondeve të BE-së (IPA I, komponenti i I-rë (2007-2013) dhe IPA II (20014-2020).

Drejtoria e Integrimit Evropian, koordinimit të projekteve dhe publikimeve në INSTAT, ka ndjekur punën në lidhje me funksionimin me efikasitet të strukturës së Zyrtarit të Lartë të Programit (SPO) për IPA I dhe II duke komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me Drejtorinë e Kontraktimeve dhe Financimeve të Huaja (CFCU) në Ministrinë e Financave për mirëmbajtjen e dosjes së SPO-së, përgatitjen e dokumentacionit dhe shkresave, përditësimin e dokumentacionit të domosdoshëm për funksionimin e strukturës së SPO-së për INSTAT, analizën e ngarkesës së punës, menaxhimin e riskut, përditësimin e regjistrit të riskut, raportimin mbi parregullsitë, etj.

INSTAT është përfitues i fondeve të Bashkimit Evropian me financim të IPA 2013 me projektin me titull “Mbështetje për Përmirësimin e Sistemit të Informacionit Statistikor” (Support the Improvement of Statistical Information System), projekt i cili është duke u menaxhuar në mënyrë të decentralizuar nga strukturat shtetërore shqiptare të ngritura për menaxhimin e fondeve të asistencës së BE-së. INSTAT në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontraktimeve dhe Financimeve të Huaja në Ministrinë e Financave ka kryer gjatë vitit 2015 të gjithë etapat e procesit të prokurimit të konsulencës së nevojshme përfshirë këtu përgatitjen e dokumentit të ToRs si dhe procesin e vlerësimit deri në përzgjedhjen e kompanisë fituese që do të zbatojë projektin. Gjatë vitit 2015, INSTAT ka përgatitur për Ministrinë e Integrimit raportet tre mujore periodike për ecurinë e punës në lidhje me zbatimin e projektit IPA 2013, aktivitetet, kontributin e buxhetit të shtetit, nivelin e disbursimeve si dhe problematika të zbatimit të projektit.

Në kuadër të financimit direkt për INSTAT të Sida (Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar) me titull “Financim direkt për një pjesë të shpenzimeve për Censusin e njëjësive

ekonomike jo- bujqësore dhe Censusin e njësive ekonomike bujqësore”, gjatë vitit 2015 u kryen disa misione ekspertize teknike për metodologjinë, përpunimin dhe analizën e të dhënave të Censurit të Njësive Bujqësore. Projekti u mbyll në muajin Maj 2015 me përgatitjen e raportit përfundimtar narrativ dhe financiar.

Në fillim të muajit dhjetor, INSTAT ka nënshkruar një marrëveshje financimi me Ambasadën Suedeze për realizimin e një projekti për përmirësimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të INSTAT. Marrëveshja e financimit midis INSTAT dhe Ambasadës Suedeze në Tiranë, u bë e mundur nga bashkëpunimi dhe kontributi i institucioneve shqiptare si Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Financave, Departamentit të Programimit të Financimeve të Huaja në Kryeministri, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes për programimin e kostove të projektit, kontributin e palës shqiptare si dhe firmosjen e marrëveshjes. Në vijim të firmosjes së marrëveshjes nga palët në fillim të dhjetorit INSTAT në bashkëpunim me Ambasadën Suedeze dhe përfaqësuesin e Statistikave të Suedisë në INSTAT, ka filluar punën për zbatimin e projektit. Projekti do të bëjë të mundur blerjen e pajisjeve të TIK për përmirësimin e infrastrukturës teknologjike dhe të komunikimit si dhe për pajisjen e Qendrës së Trajnimit që do të ngrihet në mjediset e INSTAT për kualifikimin, trajnimin e punonjësve të INSTAT dhe agjencive statistikore, por njëkohësisht do të ofrojë mundësi për kualifikimin në fushën e statistikave të studentëve, stafit akademik, studiuesve apo të individëve të tjerë të interesuar, si dhe do të shërbejë si mjedis për organizimin e seminareve teknike midis aktorëve të ndryshëm.

Me mbështetje financiare dhe asistencë teknike të ofruar nga Qeveria Zviceriane nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Tiranë (Zyrës së Bashkëpunimit Zvicerian për Shqipërinë), gjatë vitit 2015 u realizua projekti me titull “Data Elaboration in Statistics” dhe përfshinte periudhën maj-tetor 2015. Ky financim mbështeti INSTAT në kryerjen e disa aktiviteteve për përmirësimin e aftësive në shpërndarjen e informacionit statistikor dhe rritjen e aksesit të përdoruesve nëpërmjet aplikimit të teknologjive të reja. Disa prej aktiviteteve ishin krijimi i një aplikacioni për aksesimin e publikimeve të INSTAT nga përdoruesit nëpërmjet telefonave celularë,

programin për statistikat e emrave në Shqipëri, publikimin e botimit të Vjetarit të Statistikave Rajonale si dhe për organizimin me sukses të konferencës që u zhvillua në datën 17 shtator për publikimin e Vjetarit të Statistikave Rajonale dhe Rezultateve të Anketës së Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare 2014.

Qeveria Suedeze nëpërmjet Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) me ekspertizën teknike të Statistikave të Suedisë (SCB), është një prej kontribuesve më afatgjatë për INSTAT dhe sistemin kombëtar statistikor që prej fillim viteve 2000. Ky bashkëpunim është realizuar në disa faza. Aktualisht është në zbatim faza e 4-rt e këtij bashkëpunimi statistikor ndërmjet INSTAT dhe Statistikave të Suedisë (SCB) dhe mbulon periudhën Tetor 2014–Dhjetor 2017. Gjatë vitit 2015 janë realizuar aktivitete që përfshijnë rreth 18 misione afatshkurtra dhe dy vizita studimore për komponentin e menaxhimit, përmirësimin e statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, statistikat ekonomike dhe të biznesit, statistikat sociale, përmirësimin e metodologjisë statistikore dhe TIK. Gjatë vitit u kryen sipas programit dy mbledhjet e Komitetit Drejtues të këtij projekti më datë 27 maj 2015 dhe 13 Nëntor 2015 në INSTAT me prezencën e përfaqësuesve të ambasadës suedeze, Delegacionit Evropian në Tiranë, përfaqësues të SCB, të projektit dhe të punonjësve të INSTAT. Projekti ka ecur me ritme normale sipas kalendarit të parashikuar por gjithësesi duhet të punohet më shumë në gjetjen e ekspertizës së nevojshme në kohën e duhur nga ana e SCB për një pjesë të aktiviteteve të parashikuara.

Qeveria Suedeze kontribuon në zhvillimin e statistikave në rajonin e Ballkanit nëpërmjet programit të bashkëpunimit rajonal (2013-2016) me ekspertizë të Statistikave Suedeze dhe zyrës së projektit të SCB në Beograd. Qëllimi kryesor i programit rajonal të statistikave të Suedisë është të ndihmojë në zhvillimin e sistemit statistikor në rajon duke u mbështetur në metoda dhe praktika të shëndosha statistikore në përputhje me standartet BE. Kryesisht programi përqendrohet në komponentet që përfshijnë ngritje të kapaciteteve dhe asistencë teknike për përmirësimin në Statistikat Mjedisore, Metodologjia e Anketave, Statistikat Gjimore dhe organizimi i Shkollës Verore për Statistikat. Me financim të këtij programi në datat 7–11 Shtator 2015 u organizua në Shkup shkolla e verës për statistikat për 2015 me tematikë

⁴ <http://www.instat.gov.al/al/aktivitete/konferenca-mbi-statistikat-rajonale-dhe-buxhetin-e-familjes-2014.aspx>

“Përdorimi i informacionit Ndihmës në Prodhimin Statistikor “Use of Auxiliary Information in Statistical Production”. Në këtë event u festua edhe 10-vjetori i shkollës së verës të organizuar nga ky projekt. Përfaqësues nga INSTAT është pjesë e Komitetit Drejtues Rajonal (RSC) dhe merr pjesë në takimet e komitetit drejtues rajonal të projektit (RSC) duke kontribuar në emër të INSTAT për aktivitetet e mëtejshme në kuadër rajonal.

Asistencë teknike është ofruar edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar për zhvillimin e Llogarive Kombëtare dhe statistikave të qeverisë si dhe nga Banka Botërore në fushën e monitorimit të varfërisë dhe publikimin e hartave të varfërisë. Me asistencë teknike të ekspertëve të financuar Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), INSTAT ka bërë të mundur përgatitjen dhe publikimin e dy studimeve përkatësisht “Të Rinjtë në Shqipëri: Sfidat në kohët që ndryshojnë” dhe “Mplakja e Popullsisë: Situata e të moshuarve në Shqipëri” të cilat u publikuan në një Konferencë të organizuar më datë 25 Nëntor 2015.

Në lidhje me programin e bashkëpunimit rajonal statistikor të BE-së nga IPA me shumë vende përfituese gjatë vitit 2015 janë realizuar një sërë aktivitetesh për të gjithë sistemin statistikor nga IPAMB 2012 dhe IPAMB 2014, program i cili mbulon periudhën duke filluar nga 1 nëntor 2015 dhe do të zgjasë për 23 muaj. Aktivitetet e financuara nga ky program statistikor kanë të bëjnë kryesisht me përmirësimin dhe harmonizimin e metodologjisë statistikore për mbledhjen/shpërndarjen e informacionit statistikor nga zbatimi i projekteve pilot, ngritje të kapaciteteve dhe zhvillimit të aftësive të punonjësve të agjencive statistikore nëpërmjet pjesëmarrjes në grupe pune, seminare/konferenca/trajnime, vizita studimore, stazhe afatgjata në Eurostat dhe institucione statistikore të vendeve të BE-së si dhe asistencë teknike/ekspertizë e ofruar për fusha të ndryshme.

IPA 2014 me shumë vende përfituese, ka filluar zbatimin në 1 Nëntor 2015 dhe do të përfundojë 30 Shtator 2017. Ky program zbatohet nga kompania e konsulencës GOPA Consultants.

Qëllimi i këtij programi është që të përgatisë autoritetet statistikore në vendet përfituese për anëtarësim në BE duke përafuar metodologjinë dhe praktikën e tyre me kërkesat statistikore dhe integrimin e tyre në Sistemin Evropian të Statistikave.

Aktivitetet që do të zbatohen mes të tjerash përfshijnë projekte pilote në Statistikat makro-ekonomike (Llogaritë kombëtare, transmetimi i ESA 2010, PPP dhe HICP), Statistikat e Financave Qeveritare, Transporti dhe statistikave të Bujqësisë (prodhimi i bimëve dhe kafshëve), statistikave Sociale (EU-SILC, AES, LFS, dhe statistikave të krimit dhe drejtësisë) Statistikat e Biznesit (statistikave

e Tregtisë së Jashtme, Regjistrat e Biznesit, biznesi afatshkurtër, turizmi dhe informacionin shoqëror dhe në fushat statistikore me natyrë horizontale (menaxhimi cilësor, sistemi i metadatës), etj. Programi IPA MB 2014 ofron ndihmë për ndërtimin e kapaciteteve. Asistencë teknike do të jepet duke mbuluar shpenzimet për pjesëmarrjen në workshopet e projekteve pilote, mbledhjet e grupeve të punës në Eurostat, vizita studimore, kurse trajnimi dhe trajnime afatgjata.

Në kuadër të IPA 2012 dhe IPA 2014 janë zhvilluar 86 aktivitete të organizuara nga Eurostat vetëm ose së bashku me organizatat ndërkombëtare si UNECE, OECD.

Tabela 11 Aktivitetet në kuadër të projekteve IPA 2012 dhe 2014

	Takime	Workshope	Trajnime	Vizitë Studimore	Konferenca
IPA 2012	72	9	7	7	3
IPA 2014	11	-	-	-	-
Totali	83	9	7	7	3

Nga programi IPA 2012 janë kryer 5 trajnime afatgjata respektivisht për ekipin e parë për periudhën Janar – Qershor 2015 dhe 5 trajnime për ekipin i dytë për periudhën Shtator - Dhjetor 2015.

Në kuadër të projektit SIDA janë zhvilluar 15 misione teknike afatshkurtra në INSTAT. Janë zhvilluar 3 takime jashtë vendit, 7 seminare dhe 4 vizita studimore për fusha të ndryshme statistikore.

Gjatë vitit 2015 aktivitetet e financuara nga fondet e INSTAT janë: 4 financime të plota dhe një financim i pjesshëm dhe 16 financime nga organizata të huaja, ku kanë përfituar 32 punonjës.

Në kuadër të bashkëpunimit statistikor është koordinuar puna për përgatitjen dhe dërgimin e materialeve/informacioneve që kërkohen për sistemin statistikor kombëtar, INSTAT në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë ka përditësuar informacionin e Anketës së Koordinimit të Donatorëve (Donor Coordination Survey 1 janar 2015 – 31 mars 2016), që kryhet nga Eurostat për të parë aktivitetin e donatorëve në fushën e statistikave për rajonin e Ballkanit dhe Turqinë dhe të ndihmojë në planifikim më të mirë të asistencës në fushën e statistikave si dhe prioritizimin e asistencave në të ardhmen.

Atlasi Statistikor WEBGIS

Aplikacioni “Atlasi Statistikor i Shqipërisë” bazuar në WEB është vënë në dispozicion të çdo përdoruesi në vitin 2014. Ai paraqet informacionin statistikor të gjeoreferencuar, burimi i të cilit është Censusi i Popullsisë dhe Banesave, 2011. Ky aplikacion mundëson vizualizimin e të dhënave statistikore duke përzgjedhur nivelin e detajimit (Qark, Njësi vendore sipas ndarjes administrativo-territoriale të vjetër dhe asaj të re dhe në nivel gride për shpërndarjen e popullsisë.) Gjatë vitit 2015, në bazë të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen Administrativo – Territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” u bë llogaritja e variablave statistikore të 3 grupeve të mëdha: (Popullsia, Arsimi dhe Punësimi dhe Niveli i Jetesës dhe Kushtet e Banimit) bazuar në këtë ndarje të re.


Atlasi Statistikor WEBIS

- Atlasi Statistikor (WEBGIS <http://www.instatgis.gov.al>) është lançuar tashmë në websitine INSTAT-it nga maji i vitit 2014.


Publikimet - Databaza e kërkesave të përdoruesve

Database i përdoruesve u krijua për herë të parë në vitin 2009. Mbi bazën e këtij database INSTAT përcakton dhe njihet më mirë me kërkesat dhe nevojat që kanë përdoruesit për statistika. Nëse i referohemi historikut të këtij database, mund të themi që kërkesat e përdoruesve kanë pësuar një rritje të ndjeshme në vitin 2014 dhe vazhdon të ketë rritje jo aq të theksuar edhe në vitin 2015.

Figura 8 Kërkesat e përdoruesve, 2010-2014



Duke e thelluar analizën e statistikave të plotësimit të kërkesave të përdoruesve vërehet që numri i kërkesave të përdoruesve në vitin 2015 është rritur duke arritur shifrën 729 kërkesa nga 627 kërkesa në vitin 2014. Pra në ndryshim nga viti 2014 ku rritja e kërkesave ndaj 2013 ishte me 83 % në vitin 2015 kjo rritje nuk është aq e ndjeshme prej afro 16 %. Nëse do të bënim specifikimin e mëtejshëm të këtyre kërkesave mund të themi që numrin më të madh të tyre e zënë kërkesat e statistikave ekonomike me 23,72 % duke u pasuar nga kërkesat e statistikave sociale 11 %, statistikave mbi tregun e punës dhe ato të llogarive kombëtare me 7,5% etj.

Figura 9 Klasifikimi i numrit të kërkesave të përdoruesve sipas fushave specifike statistikore

Numrin më të madh të kërkesave të plotësuar në vitin 2015 e zënë statistikat ekonomike me 351 kërkesa, ku kryesojnë statistikat e Çmimeve me 173 kërkesa të plotësuar, pasuar nga statistikat e tregtisë së jashtme me 71 kërkesa si dhe statistikat ekonomike pranë ndërmarrjeve me 55 kërkesa, etj. Një pasqyrë më të hollësishme mund ta konsultoni në tabelën e mëposhtme:

Tabela 12 Numri i kërkesave të përdoruesve sipas fushave specifike statistikore

Kërkesat e përdoruesve për Statistika të:	2014		2015	
	Numër	Përqindje	Numër	Përqindje
Çmimeve	195	31,1	173	23,7
Tregtisë së Jashtme	58	9,3	71	9,7
ASN e prodhimit	70	11,2	55	7,5
Turizmit e Transportit	23	3,7	52	7,1
Popullsisë	77	12,3	80	11
Arsimit	14	2,2	21	2,9
Shëndetit	8	1,3	26	3,6
Të ardhurat e Konsumi në familje	40	6,4	39	5,3
Tregu i Punës	43	6,9	55	7,5
Hartografisë	8	1,3	15	2,1
Regjistrin të Ndërmarrjeve	34	5,4	44	6
Llogarive Kombëtare gjithsej	34	5,4	55	7,5
Bujqësisë gjithsej	23	3,7	43	5,9
Gjithsej	627	100	729	100

Marketimi i produktit Statistikor

Marketimi i produktit Statistikor dhe Përditësimin në vazhdimësi i Custom Database për të përmirësuar informacionin për marketimin e produktit statistikor dhe për rritjen e nivelit të shërbimit ndaj përdoruesit. Marketingu dhe shpërndarjen e botimeve të INSTAT ndaj klientëve, bazuar në Strategjinë e Marketingut miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm si dhe kryerja e marketingut të informacionit statistikor të publikuar, nëpërmjet kanaleve të ndryshme të marketingut.

Të dhënat e faqes www.instat.gov.al, statistikat e webit

Gjate vitit 2015 në webin e INSTAT ka patur 210,437 sesione⁵ nga 194.870 që ishin në vitin 2014. Sesionet gjatë vitit 2015, janë rritur me 8 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Totali i përdoruesve⁶ gjatë vitit 2015 ishte 104.995 nga 92.814 që ishte në vitin 2014, duke përsuar një rritje prej 13,12%. Për vitin 2015 faqja web e INSTAT është shikuar⁷ 997.548 nga 985.280 në vitin 2014 me një rritje prej 1,25 %.


Në ankesin nr. 1 në fund të materialit mund të shikohet më qartë se ku kanë aksesuar përdoruesit më shumë në faqen e INSTAT si dhe për orientimin e politikave në të ardhmen.

Një risi tjetër e cila shërben për të shpërndarë produktin statistikor është dhe numri i përdoruesve të telefonave mobile si dhe tablet në faqen e INSTAT. Siç shihet nga grafiku numri i përdoruesve mobile dhe tablet ka përsuar një rritje të madhe çka duhet të synojë që produktet e reja të instat duhet të fokusohen në versione telefonike si dhe objektiv i këtij viti është ndërtimi i versionit mobile të faqes së INSTAT. Grafiku më poshtë e ilustron.

⁵ Total number of Sessions within the date range. A session is the period time a user is actively engaged with your website, app, etc. All usage data (Screen Views, Events, Ecommerce, etc.) is associated with a session.

⁶ Users that have had at least one session within the selected date range. Includes both new and returning users.

⁷ Pageviews is the total number of pages viewed. Repeated views of a single page are counted.


Figura 10 Numri i përdoruesve sipas llojit të pajisjes

Gjatë vitit 2015, 10 vendet kryesore që kanë vizituar faqen zyrtare të INSTAT janë Shqipëria, SHBA, Kosovë, Itali, Gjermani, Kinë, Angli, Greqi, Maqedoni dhe Polonia. Shqipëria kryeson renditjen me 151.686 sesione nga 146.977 sesione që kanë rezultuar në vitin 2014, duke pësuar një rritje prej 3,20 %.

Tabela 13 Vendet që kanë vizituar më shumë faqen e INSTAT (www.instat.gov.al)

	2014	2015
Shqipëri	146.977	151.686
SHBA	5.372	6.957
Kosovë	5.387	6.510
Itali	4.867	4.791
Gjermani	2.415	3.258
Kinë	221	3.202
Angli	2.571	3.079
Greqi	2.372	2.371
Maqedoni	1.823	2.290
Poloni	1.079	1.752

Figura 11 Vendet që kanë vizituar më shumë faqen e INSTAT në % për dy vitet e fundit



Në aplikacionin INSTATGIS.GOV.AL gjatë vitit 2015 janë realizuar 8.448 sesione nga 3.919 që ishin në vitin 2014, me një rritje prej 116%. Në vitin 2015 janë 6.533 përdorues që kanë hyrë në këtë ndërfaqe të INSTAT duke shënuar një rritje prej 174% krahasuar me vitin 2014. Qëndrimi mesatar për çdo sesion është 3.04 minuta. Këto sesione janë realizuar nga (91,65 %) në versionet desktop, mobile (7,21 %) dhe tablete (1,14 %).

Të dhënat mikro


Zhvillimi i ri për të siguruar vlera të shtuara të të dhënave sugjeronte futjen e bazave të të dhënave statistikore (mikrodatave) kjo i lejon përdoruesit të krijojnë dhe të analizojnë statistikatat e tyre, në një masë të gjërë. Në janar të vitit 2014, INSTAT ka bërë publike të dhëna mikro për të gjithë përdoruesit për temat:

- Tregu i Punës
- Anketa e Forcave të Punës 2007 - 2013
- Anketa e Përdorimit të Kohës 2010-2011
- Anketat e Matjes së Nivelit të Jetesës: 2002, 2005, 2008, 2012
- CENSUS: 3 % e të dhënave të Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011

· Anketa e Migracioni të kthimit dhe ri-integrimit 2013

Bazuar në të dhënat e ofruara nga Google Analytics për faqen e internetit të INSTAT-it është llogaritur numri i shkarkimeve të mikrodatave për vitin 2015, gjatë këtij viti numri i shkarkimeve të mikrodatave ishte 8.262, një vit më parë (viti 2014) numri i shkarkimeve të mikrodatave ishte 5.949, kemi një rritje të shkarkimeve me 39 % për vitin 2015.

Figura 12 Shkarkimi i të dhënave mikro




Rrjeti social facebook “Instituti i Statistikave”

Instituti i Statistikave lançoi për herë të parë faqen e tij zyrtare në rrjetin social Facebook, më 20 Maj 2014.

Numri i personave që kanë vizituar faqen, e kanë parë atë, apo një nga postimet e faqes gjatë periudhës Janar 2015 - Dhjetor 2015 është 195.320 persona.

Ndjekës të faqes FB

Në vitin 2015 kemi gjithsej 3.337 ndjekës të faqes së FB . Në dt. 1 Janar 2015 faqja ka pasur 1.832 pëlqime. Nga kjo datë deri në 31 Dhjetor 2015 kemi një rritje me 1.505 ndjekes. Nga këto 61 % janë femra dhe 39 % janë meshkuj.



Vlerësimi i faqes nga personat që kanë hyrë ne FB është një mesatare 4,7 nga 22 persona. Personat me vleresim maksimal 5 Yje janë 20, 2 janë me 4 yje dhe 1 është me vlerësim minimal 1.

Postimet

Numri total i postimeve nga data 1 Janar 2015-31 Dhjetor 2015 eshte 368, postime të cilat kanë arritur një shikueshmëri prej 195.320 personash me një mesatare 533.661 për çdo postim. Postimet në faqe janë të bazuara në kalendarin e eventeve të facebook (duke respektuar kalendarin e publikimeve të INSTAT), i cili përmban datat e daljes së publikimeve dhe eventeve të tjera të rëndësishme. Statuset të cilat kanë pasur shikueshmërinë më të lartë janë:

- A jeni kureshtarë të dini sa persona kanë të njëjtin emër me ju në Shqipëri? Kërko emrin... <https://instatemra.shinyapps.io/emra/>, me shikueshmëri 9.467 persona dhe 47 pëlqime, dhe 24 share
- Konferenca mbi Statistikat Rajonale dhe Buxhetin e Njësive Ekonomike Familjare 2014, me një shikueshmëri prej 4.616 personash dhe 64 pëlqime, 5 komente dhe 3 share
- Binjakëzimi i INSTAT me Zyrën Qendrore të Statistikave të Irlandës, (CSO) me shikueshmëri 3.954 personash dhe 87 pëlqime dhe 1 koment
- Portali online Instatgis www.instatgis.gov.al; me shikueshmëri 3.538 personash dhe 30 pëlqime dhe 21 share
- Statusi “INSTAT ju uron Gëzuar Festat!” me shikueshmëri 5.515 personash dhe 62 pëlqime, 3 komente dhe 3 share
- PSE PO PLAKET SHQIPËRIA? me shikueshmëri 3.104 personash dhe 45 pëlqime dhe 13 share

Eventet e postuara në faqen e Facebook

25.11.2015

“Mplakja e Popullsisë dhe Të Rinjtë në Shqipëri”

Event i organizuar në Hotel Tirana International nga INSTAT.

23.10.2015

“Konferenca Rajonale mbi Statistikat Gjimore në Shqipëri”

Event i organizuar në Tirana International Hotel nga INSTAT.

20.10.2015

“Dita e Hapur për Statistikat”

Event i organizuar në Fakultetin Ekonomik nga INSTAT.

07.10.2015

“Migracioni i kthimit dhe ri-integrimi në Shqipëri, 2013”

Event i organizuar në Tirana International Hotel nga INSTAT.

21.05.2015

“Analiza e të dhënave të Census”

Event i organizuar në Tirana International Hotel nga INSTAT.

20.05.2015

“Publikimi: Femra dhe Meshkuj 2015”

03.02.2015

“Trajnim për tabelat e Burim – Përdorimeve”

Event i organizuar në Tirana International Hotel nga INSTAT.

Të gjithë aktivitetet e INSTAT janë bërë publike për ndjekësit e faqes 2-3 ditë përpara aktivitetit nëpërmjet opsionit të krijimit të një eventi në facebook. Çdo aktivitet është përcjellë edhe me foto.

Mbulimi i INSTAT nga media

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015, përmendja dhe citimi për INSTAT është vërejtur gjithsej 4 152 herë në përmbajtjen e 2 338 artikujve të botuar në shtypin shqiptar dhe kosovar (Tab. 3, 4, 5, 6). Në faqet e para të gazetave të përditshme sasia e përmendjeve është 188.

Frekuenca më e lartë e përmendjeve është regjistruar në 29 Gusht dhe 10 Tetor, ndërsa për sa u përket gazetave, sasia më e lartë e përmendjeve vërehet në gazetat “Rilindja Demokratike”, “Standart” dhe revista “Monitor”.

Tabela 14 Frekuenca e përmendjes së INSTAT në gazetat e monitoruara gjatë periudhës
Janar – Dhjetor 2015

	Albanian Daily News																												
	Dita	G MAPO	Gazeta 55	Gazeta Shqiptare	Integrimi	Koha Jonë	Panorama	Revista Java	Revista Monitor	Rilindja Demokratike	Shekulli	Shqip	Shqiptarja	Sot	Standard	Telegraf	Tema	Tirana Observer	KS Bota Sot	KS Epoka e Re	KS Koha Ditore	KS Kosova Sot	KS Zeri	Sporti Ekspres	Pano	GazetaDita	Revista Psikologji	Grand Total	
KLSH	4	254	178	499	284	38	666	464	1	17	487	200	466	307	737	269	1392	192	477	11	2			1	1	10		6947	
KLD	2	425	195	104	190	113	139	370	23	2	145	225	451	378	581	144	397	206	98	24	43	6	26	10				4297	
INSTAT	318	177	114	284	181	87	273	176	8	269	625	64	258	186	218	292	113	191	198	51	12	10	8	39				4152	
QSUT	7	201	50	122	202	15	80	250	12	1	196	184	246	159	192	66	353	98	100	12	1	4	1	6		46	1	2605	
Grand Total	331	1057	537	1009	857	253	1148	1260	44	289	1453	673	1421	1030	1728	771	2255	687	873	98	56	22	35	55	1	1	56	1	18001

Tabela 15 Frekuenca e përmendjes së INSTAT në faqet e para të gazetave të monitoruara gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015

	Albanian Daily News	Dita	G MAPO	Gazeta 55	Gazeta Shqiptare	Integrimi	Koha Jonë	Panorama	Rilindja Demokratike	Shekulli	Shqip	Shqiptarja	Sot	Standard	Telegraf	Tema	Tirana Observer	GazetaDita	Grand Total
KLSH		4	8	21	11		25	15	18	6	25	11	20	5	99	6	24	10	308
KLD		11	9	8	3	2	2	7	5	10	34	14	34	6	22	4	9		180
QSUT		7	4	5	15	1		9	5		13	3	7	5	12	5	5	38	134
INSTAT	19	2	3	3	2	6	3	1	4		16	1	4	13	3	6	5		91
Grand Total	19	24	24	37	31	9	30	32	32	16	88	29	65	29	136	21	43	48	713

Tabela 16 Shpërndarja sipas rubrikave të përmendjes dhe citimeve të INSTAT sipas gazetave të monitoruara gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015

Rubrikat	Albanian Daily News	Dita	G MAPO	Gazeta 55	Gazeta Shqiptare	Integrimi	Koha Jonë	Panorama	Revista Java	Rilindja Demokratike	Shekulli	Shqip	Shqiptarja	Sot	Standard	Telegraf	Tema	Tirana Observer	Revista Monitor	KS Bota Sot	KS Epoka e Re	KS Koha Ditore	KS Kosova Sot	KS Zeri	Grand Total
Aktualitet - Current				1		1	2			1							2	3							10
Ekonomi - Economy	192	107	50	120	112	47	141	90	2	368	28	135	116	130	171	31	100	94	257	18	1		5	17	2332
Kronikë - Chronicle		3	5		6		9	5		7	3	4	4	5	1		10	3	5	1			1	2	74
Kulturë - Culture			4	4	1			1			1	2				1		2	1	1	1	2		1	22
Miscellaneous	19	2	3	3	2	6	3	1		4	16	1	4	13	3	6	5								91
Ndërkombëtare	24			3			3			3				1			3		1	3	1				42
Politikë - Politics	53	35	30	68	33	18	40	44	6	124	14	45	25	47	49	46	46	33	3	24	6	5	2	9	805
Shendeti - Health		1					2																		3
Sociale - Social	30	29	22	85	27	15	73	35		119	18	57	38	31	58	32	24	57	2	4	3	3		10	772
Sport																		1							1
Grand Total	318	177	114	284	181	87	273	176	8	625	64	258	186	218	292	113	191	198	269	51	12	10	8	39	4152

Tabela 17 Shpërndarja sipas rubrikave e numrit të artikujve në të cilët është përmendur INSTAT sipas gazetave të monitoruara gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015

Rubrikat	Albanian Daily News	Dita	G MAPO	Gazeta 55	Gazeta Shqiptare	Integrimi	Koha Jonë	Panorama	Revista Java	Rilindja Demokratike	Shekulli	Shqip	Shqiptarja	Sot	Standard	Telegraf	Tema	Tirana Observer	Revista Monitor	KS Bota Sot	KS Epoka e Re	KS Koha Ditore	KS Kosova Sot	KS Zeri	Grand Total
Aktualitet - Current			1		1	1				1						2	1								7
Ekonomi - Economy	115	71	25	71	44	28	60	31	1	192	17	69	58	65	100	17	52	32	139	11	1		2	14	1215
Kronikë - Chronicle		3	2	5		3	5			4	1	2	2	4	1		2	3	1	1			1	2	42
Kulturë - Culture			2	4	1			1			1	2			1		2	1	1	1	2			1	20
Miscellaneous	15	2	3	3	2	6	3	1		3		12	1	3	13	3	6	4							80
Ndërkombëtare	23			3			3			2				1			3		1	2	1				39
Politikë - Politics	36	22	22	41	21	15	23	20	5	72	13	31	19	33	26	16	28	19	2	19	5	5	2	7	502
Shendeti - Health		1					1																		2
Sociale - Social	20	16	14	45	15	12	31	16		66	14	32	24	11	32	23	15	25	2	4	3	3		7	430
Sport																		1							1
Grand Total	209	115	68	168	88	62	125	74	6	339	46	147	106	117	172	60	108	87	146	38	11	10	5	31	2338

Tabela 18 Parametra të artikujve ku përmendet INSTAT sipas gazetave të monitoruara gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015

Gazetat	Përmendje	Artikuj	Sipërfaqe Publikimi
Albanian Daily News	318	209	66263
Dita	177	115	35444
G MAPO	114	68	21726
Gazeta 55	284	168	53752
Gazeta Shqiptare	181	88	28063
Integrimi	87	62	23363
Koha Jonë	273	125	39285
KS Bota Sot	51	38	10517
KS Epoka e Re	12	11	6099
KS Koha Ditore	10	10	5402
KS Kosova Sot	8	5	1131
KS Zeri	39	31	6685
Panorama	176	74	23199
Revista Java	8	6	3663
Revista Monitor	269	146	79142
Rilindja Demokratike	625	339	90487
Shekulli	64	46	10137
Shqip	258	147	49826
Shqiptarja	186	106	13751
Sot	218	117	27272
Standard	292	172	59605
Telegraf	113	60	32612
Tema	191	108	40841
Tirana Observer	198	87	28172
Grand Total	4152	2338	756437

Legjenda e parametrave

Përmendje - Numri i përmendjeve për çdo gazetë të cilët plotësojnë kriteret e përzgjedhjes;

Artikuj - Numri i artikujve të publikuar për çdo gazetë të cilët plotësojnë kriteret e përzgjedhjes;

Sipërfaqe publikimi - Sipërfaqja e përgjithshme e publikimit të matur me sasinë e faqeve të plota të gazetave;

Publikimet - Të dhënat e faqes www.instat.gov.al

INSTAT publikon botime me periodicitet mujor, tremujor, gjashtëmujor, vjetor dhe botime special. Të gjitha publikimet përditësohen në website duke ndjekur kalendarin e publikimeve.

71 është numri i botimeve të publikuara në website të INSTAT gjatë vitit 2015, nga këto, 15 publikime janë vjetore dhe speciale të cilat edhe janë printuar në formë libri.



Buletini Statistikor Tremujor

Buletini Statistikor tremujor sjell informacion për indikator social dhe ekonomik. Në këtë publikim janë përfshirë të dhëna për demografinë, arsimin, shëndetësinë, tregun e punës, prodhimin, tregtinë e jashtme, transportin, ndërtimin, turizmin, regjistrin e ndërmarrjeve etj. Ky publikim është i disponueshëm në shqip dhe anglisht.



Femra dhe Meshkuj në Shqipëri, 2015

Qëllimi i këtij publikimi është të përfshijë një gamë akoma më të gjerë treguesish duke përfshirë të dhëna nga burime të ndryshme nga anketa dhe burime administrative. Për momentin të dhënat nga anketat mbulojnë vetëm sferën sociale. Shumë shpejt publikimi, i cili do të përditësohet çdo vit, do të tentojë të përfshijë të dhëna nga anketa ekonomike dhe bujqësore. Kjo do të bëhet në funksion të analizës së këtij dimensionit në sa më shumë fusha për të siguruar njohuri sa më të plota të situatës së femrave dhe meshkujve në Shqipëri.



Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve Ekonomike, 2013

Anketa strukturore pranë ndërmarrjeve ka për qëllim të ofrojë informacion mbi strukturën ekonomike, financiare dhe karakteristikat kryesore të ndërmarrjeve të regjistruara në regjistrin statistikor të ndërmarrjeve sipas aktivitetit ekonomik dhe që janë aktive në periudhën referuese Janar – Dhjetor 2012. Në këtë botim, statistikën janë paraqitur sipas aktivitetit ekonomik dhe madhësisë së ndërmarrjeve.



Tregu i Punës, 2014

Statistikat e tregut të punës mund të përdoren për një numër analizash të ndryshme, si ato makro-ekonomike apo punësimi i parë si një burim i të ardhurave familjare. Punësimi pasqyron strukturën e tregjeve të punës apo sistemeve ekonomike si dhe ndjek ciklin e biznesit. Shkalla e papunësisë, nga ana tjetër, është një tregues i rëndësishëm si në aspektin social ashtu dhe në atë ekonomik. Ky tregues nuk tregon vetëm përqindjen e forcës punëtore që nuk punon, por edhe kapacitetin e papërdorur të punës së një vendi.



Regjistri i Ndërmarrjeve Ekonomike, 2014

Regjistri i Ndërmarrjeve është bazë për hartimin e statistikave të nevojshme për dhënien e treguesve afatshkurtër dhe të zhvillimeve strukturore ekonomike. Ky regjister bazohet në informacionin e marrë nga burimet administrative si: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve(DPT), Qendra Kombëtare e Regjistrimit(QKR) si dhe nga vrojtimet statistikore që organizon INSTAT apo agjencitë statistikore.



Ecuria e Tregtisë së Jashtme, 2010 - 2014

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave përfshijnë të dhëna mbi tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe pjesës tjetër të botës. Informacioni statistikor është i një rëndësie thelbësore për ekonominë shqiptare dhe politikat ekonomike, si dhe për analizën e zhvillimeve të tregut të mallrave individuale. Statistikat përmbajnë të dhëna të cilat ndahen sipas vendeve partnere, grupvendeve, kapitujve dhe seksioneve të Nomenklaturës së Kombinuar dhe seksioneve të Klasifikimit Ndërkombëtar Standart i Tregtisë (SITC).



Tregtia e Jashtme e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve, 2011-2014

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave përfshijnë të dhëna mbi tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe pjesës tjetër të botës. Statistikat përmbajnë të dhëna të cilat ndahen sipas vendeve partnere, grupvendeve, kapitujve dhe seksioneve të Nomenklaturës së Kombinuar dhe seksioneve të Klasifikimit Ndërkombëtar Standart i Tregtisë (SITC).



Tabelat e Burimeve - Përdorimeve dhe Input - Output

Tabelat e burimeve dhe përdorimeve ofrojnë portretin më të detajuar të një ekonomie. Ato ofrojnë një analizë të detajuar të procesit të prodhimit dhe përdorimit të mallrave dhe shërbimeve dhe të gjenerimit të të ardhurave të krijuara. TBP-të ofrojnë një kuadër të qëndrueshëm për balancimin e llogarive kombëtare. Këto tabela janë mjaft komplekse dhe hartimi i tyre është një sfidë e madhe për çdo vend.




Vjetari Statistikor 2010-2014

Vjetari Statistikor, është një botim prej 206 faqesh, i ndarë në 14 kapituj të cilët përveç pjesës shkrimore dhe metodologjike, përmbajnë 165 tabela dhe 105 grafikë, të cilët kanë objektiv të sigurojnë të dhëna dhe një përshkrim më të plotë të strukturave sociale dhe ekonomike. Objektivi i këtij Vjetari ka qenë të mbledhë, sistemojë e koordinojë në mënyrë të qëndrueshme përbërësit më thelbësorë të informacionit statistikor, informacion i cili do të shërbejë për të treguar një pamje të gjerë të proceseve shoqërore dhe ekonomike të vendit. Botimi është i disponueshëm edhe në formatin elektronik duke lehtësuar kështu përdorimin e të dhënave.



Anketa e Kostove të Punës, 2013

Anketa e Kostove të Punës kryhet pranë ndërmarrjeve dhe përbën një nga burimet kryesore për të matur nivelet dhe përbërjen e kostove të punës, Kostot e punës përbëjnë komponentin më të rëndësishëm të kostos së prodhimit të të mirave dhe shërbimeve dhe i korrespondojnë kostove të një punëdhënësi për punësimin e stafit punonjës. Objektivi kryesor i Anketës së Kostove të Punës është mbledhja e informacionit mbi strukturën e kostove të ndërmarrjeve për faktorin e prodhimit punë.



Të Rinjtë në Shqipëri: Sfidat në kohët që ndryshojnë

“Të Rinjtë në Shqipëri: Sfidat në kohët që ndryshojnë”, do të shërbejë më së miri për të pasur një vlerësim më të qartë të jetesës së të rinjve shqiptarë, përfshirë popullsinë e grupmoshës 15 deri në 29 vjeç. Kjo fazë e jetës shënon një periudhë me përvoja dhe ngjarje të rëndësishme, duke përfshirë përfundimin e shkollimit, tranzicionin nga shkolla në tregun e punës, martesën dhe krijimin e familjes, seksualitetin, etj. Sjellja dhe vendimet e përfshira në këto përvoja dhe ngjarje shpesh paraqesin sfida për të rinjtë, në aspektin social, ekonomik dhe emocional. Njëkohësisht, këto zgjedhje në jetë i vendosin të rinjtë në pozicionin e agjentit kryesor të ndryshimit social.



Mplakja e Popullsisë: Situata e të moshuarve në Shqipëri

“Mplakja e Popullsisë: Situata e të moshuarve në Shqipëri”, do të shërbejë më së miri për të pasur një vlerësim më të qartë të jetesës së të moshuarve të grupmoshës mbi 65 vjeç. Shqipëria po fillon të përjetojë efektet e mplakjes së popullsisë. Gjatë dy dekadave të fundit vendi ka patur një transformim të thellë demografik të shoqëruar me një rritje të numrit të personave mbi 65 vjeç dhe rënie të numrit të fëmijëve dhe të të rinjve. Politikë-bërësit duhet të jenë të përgatitur për këtë proces, i cili do të ketë ndikimin e tij në dekadat që vijnë në të gjitha aspektet e jetës: ekonomike, sociale dhe politike.



Shqipëria në Shifra 2014

Shqipëria në Shifra paraqet në mënyre sintetike të dhëna statistikore për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë. Botimi përmban 16 kapituj: Demografia, Statistika Juridike, Parlamenti, Arsimimi dhe Njohuritë, Shëndetësia, Kultura, Papunësia, Punësimi, Çmimet dhe Konsumi, Tregtia me Pakicë, Tregtia e Jashtme, Transporti, Turizmi, Llogaritë Kombëtare, Banka, Regjistri i Ndërmarrjeve. Botimi është në shqip.

Kontaktet e institucionit



INSTAT - Instituti i Statistikave

Bul."Zhan D'Ark", Nr .3 Tiranë, Shqipëri

Tel+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356

Fax+(355) 4 2228300

www.instat.gov.al

info@instat.gov.al